



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr.2487, datë 26.06.2014

Për

“ Miratimin e nivelit të pagesës mbikqyerjes tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2014 ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira Nurçe	Anëtare

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 26.06.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi materialin shkresor të paraqitur nga Drejtoria e Financës, Pagesave dhe Statistikave , me objekt:

“ Miratimin e nivelit të pagesës mbikqyerjes tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2014 ”

I. B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 24 pika 1/a , neni 117 pika 1 dhe neni 119 pika 1/a të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*).
2. Regullore Nr.20, datë 19.02.2010 Mbi “ Pagesat për mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike”
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 104, datë 26.02.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare për vitin 2014”
4. Memo: Mbi deklarimin e të ardhurave nga mbikqyerja e tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2013 dhe miratimin e nivelit (koeficientit) pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2014.

II. K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

1. Memo: Mbi deklarimin e të ardhurave nga mbikqyerja e tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2013 dhe miratimin e nivelit (koeficientit) pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2014.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 104, datë 26.02.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare për vitin 2014”.

si dhe diskutimet në mbledhje,

III. V Ë R E N:

Propozimi për miratimin e nivelit (koeficientit) pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2014 per financimin e koston administrative të vitit 2014 që financohet nga pagesat e mbikqyerjes tregut të komunikimeve elektronike, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.104, datë 26.02.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare për vitin 2014” i cili është në shumën 259,500,000 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) lekë.

IV. P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Këshilli Drejtues, duke rënë dakord me propozimi për miratimin e nivelit (koeficientit) pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2014 per financimin e koston administrative të vitit 2014 që financohet nga pagesat e mbikqyerjes tregut të komunikimeve elektronike.

V. V E N D O S I:

1. Të miratojë nivelin (koeficientin) e pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike të vitit 2014 në 0.112834% të ardhurës vjetore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të vitit 2013, për financimin e koston administrative të vitit 2014.
2. Të mos u faturohet pagesa vjetore e mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike sipërmarrësve, me pagesë vjetore nga mbikqyerja e tregut nën 1000 (Njëmijë) lekë.
3. Të ngarkohet Drejtoria e Financës, Pagesave dhe Statistikave për faturimin dhe arkëtimin e pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE